

**VENDIM**  
**Nr.642, datë 30.9.2004**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.653, DATË 25.9.2003 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE "PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E  
KONVIKTEVE, BURSAT E SHETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË  
STUDENTËVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "c" të nenit 32 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.653, datë 25.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "e" e pikës 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"e) studentët, që vazhdojnë studimet në specialitetet matematikë e fizikë, pas përfundimit të plotë të vitit të parë, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të veçantë të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, në konsultim me shkollat e larta, bazuar në rezultatet e arritura prej tyre në mësim dhe kërkimin shkencor."

2. Në pikën 3, fjalët "- humbasin vitin shkollor;" të zëvendësohen me "- nuk rezultojnë kalues në të gjitha lëndët mësimore të vitit shkollor paraardhës;"

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës harton planin e shpërndarjes së bursave, sipas kuotave të miratuara në nivel rrethi. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, pas konsultimit me strukturat e pushtetit vendor, bëjnë planin e shpërndarjes së bursave në bashki e komuna, në përputhje me kërkesat e paraqitura prej tyre. Bashkitë dhe komunat, sipas planit të përcaktuar për to, vendosin dhënien e bursave dhe i dërgojnë drejtorisë arsimore rajonale apo zyrës arsimore përkatëse, në rrugë zyrtare, vendimet dhe dokumentacionin e nevojshëm për bursën.

Drejtoritë arsimore rajonale apo zyrat arsimore duhet të dërgojnë pranë shkollave përkatëse listën emërore të nxënësve dhe të studentëve bursistë, së bashku me vendimet origjinale të bashkive dhe komunave. Një kopje e listës emërore të studentëve bursistë dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës."

4. Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

"8. Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, për vitin shkollor 2004-2005, i jepen 900 bursa për arsimin e mesëm dhe 700 bursa për arsimin e lartë."

5. Pika 9 ndryshohet si më poshtë vijon:

"9. Efektet financiare për bursat për vitin shkollor 2004-2005, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, për pjesën e vitit 2004, dhe nga buxheti që do të miratohet për këtë Ministri për vitin 2005, për pjesën e vitit 2005."

6. Pika 10 ndryshohet si më poshtë vijon:

"10. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga viti i dytë e lart, për të gjitha kategoritë e shkollave, është data 15 nëntor 2004, ndërsa për vitet e para data 30 nëntor 2004."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**